

L I G J
Nr.9048, datë 7.4.2003

PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; nr. 9882, datë 28.2.2008; nr. 10 137, datë 11.5.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 59 pika 1 shkronja "g", 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, parashikimi i rregullave për mbrojtjen e saj dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve që veprojnë në këtë fushë.

Neni 3

(Shtuar fjalë në fund të pikës 12, shfuqizuar pika 5 dhe 22, shtuar pika 35 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ansambël arkitekturor" është tërësia e një numri ndërtesash, të cilat i lidh një koncept i njëjtë krijues.
2. "Ansambël historik" është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike me vlera historike.
3. "Ansambël muzeal" është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike që mbrohet nga shteti.
4. "Ansambël urban" është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike me një qendër qytetare, e cila mund të formohet prej një ose disa pjesëve të një zone banimi.
5. Shfuqizuar.
6. "Arkitekturë tradicionale" është arkitektura e së kaluarës me zbatim kohor relativisht të gjerë.
7. "Dëmtim" është ndërhyrja në dëm të pasurisë kulturore, materiale ose jomateriale, që cenon funksionin ose pamjen origjinale të këtyre pasurive.
8. "Folklor gojor" është teksti i krijimit popullor, i pashoqëruar me muzikë, i cili lexohet ose tregohet.
9. "Folklor instrumental" është krijimi muzikor popullor i interpretuar me vegla

muzikore popullore.

10. "Folklor koreografik" janë valle dhe krijime që kërcëhen me ose pa shoqërim muzikor.

11. "Folklor vokal" janë krijime muzikore të kënduara ose të interpretuara me tekst dhe muzikë.

12. "Institucione shtetërore të specializuara" janë Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Arkivi i Filmit dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike Kulturore, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, drejtoritë rajonale të kulturës kombëtare, Fototeka "Marubi", Muzeu i Artit Mesjetar Korçë, Galeria Kombëtare e Arteve, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit.

13. "Inventarizim" është regjistrimi dhe identifikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.

14. "Katalogim informatik" është regjistrimi i të dhënave, sipas kritereve të caktuara shkencore, për identifikimin dhe administrimin e shpejtë të pasurive kulturore.

15. "Mbrotjtje" është mënyra dhe forma e natyrës juridike ose jo të ruajtjes, mirëmbajtjes, rindërtimit, restaurimit ose konservimit të pasurisë së trashëgimisë kulturore.

16. "Monument kulture" është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore që mbrohet nga shteti.

17. "Objekt në mbrotjtje paraprake" është pasuria kulturore, materiale, në pritje për t'u shpallur monument kulture nga organi përgjegjës.

18. "Objekt nën vrotjtje" është pasuria kulturore e pashpallur monument kulture, në shqyrtim për t'u përfshirë në mbrotjtje nga shteti.

19. "Objekt unikal" është vepra arkitektonike me përdorim të zakonshëm ose me funksione artistike a zbuluese dhe që, deri në çastin e dhënë, është identifikuar si e vetme në trashëgiminë kulturore e materiale.

20. "Park arkeologjik" është hapësira me vlera mjedisore, në të cilën ruhen rrënoja ndërtimore, të zbuluara prej gërmimeve arkeologjike që mbrohen nga shteti.

21. "Pasaporta e objektit" është kartela e identifikimit të një objekti të trashëgimisë kulturore, ku vendosen fotografia e objektit, filmimet, skicat, vendndodhja, përmasat, pesha, materiali, kodi kompjuterik, autori, vendi i ruajtjes, përshkrimi dhe historiku.

22. Shfuqizuar.

23. "Qendër historike" është ansambli qytetar ose fshatar me vlera historiko-kulturore që mbrohet nga shteti.

24. "Qytet-muze" është qendra qytetare që mbrohet nga shteti për vlerat historiko-kulturore.

25. "Restaurim" është vlerësimi i thelbit origjinal të monumenteve nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjes në pah të vlerave të tyre.

26. "Status i objektit" është gjendja juridike e një objekti.

27. "Trashëgimi me vlera kombëtare" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore me vlera historiko-kulturore për kombin.

28. "Trashëgimi me vlera muzeale" është pasuria kulturore, materiale, e cila, për vlerat e veta historiko-kulturore ose artistike, meriton të ruhet në muze të profileve të ndryshme.

29. "Trashëgimi me vlera të veçanta" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore me vlera të spikatura.

30. "Trashëgimi me vlera unike" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore e vetme në llojin e vet.

31. "Vlerë arkeologjike" janë monumente, vendbanime historike të llojeve të ndryshme, objekte ose pjesë veprash ndërtimore apo vendbanimesh, të dala prej gërmimeve arkeologjike,

me vlera historiko-kulturore.

32. “Vlerë etnologjike” janë vlera të kulturës, materiale ose shpirtërore, të cilat lidhen me tiparet thelbësore të një kombi.

33. “Zeje tradicionale” është pjesa materiale dhe përvoja e përqendruar e mjeshtreve tanë popullorë në shekuj.

34. “Zonë arkeologjike” është sipërfaqja në të cilën gjenden monumente të zbuluara nga gërmimet arkeologjike ose është dëshmuar qenia e shtresave me përmbajtje arkeologjike.

35. “Zonë-muze” është njësi territoriale brenda qytetit, me vlera muzeale, e cila përbëhet nga një grup objektesh me vlera të rëndësishme kulturore.

Neni 4

Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare.

I. Vlerat materiale të trashëgimisë kulturore janë:

1. Objekte të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, ku përfshihen:

a) qendra, zona dhe rajone, të banuara ose të pabanuara, me vlerë arkeologjike, historike, etnologjike, arkitektonike dhe inxhinierike. Të tilla vlerësohen edhe objektet e kësaj natyre në gjendje rrënoje, me vjetërsi mbi 100-vjeçare;

b) ansamble urbane, arkitekturore dhe historike, ndërtime ose konstruksione ndërtimore me vlera të veçanta. Të tilla janë edhe objektet e kësaj natyre në gjendje rrënoje, me vjetërsi mbi 100-vjeçare.

2. Objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, ku përfshihen:

a) objekte, pjesë ose elementë të objekteve, të përfshira në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, si mozaikë, kolona, kapitule, skulptura, piktura murale, ikona, ikonostase, tavane karakteristike, mbishkrime, gurë varresh, me vjetërsi mbi 100-vjeçare;

b) materiali i lëvizshëm arkeologjik, që del nga gërmimet arkeologjike, grumbullohet nga gjurmimet arkeologjike, ose vjen si gjetje rastësore apo që ruhet në koleksione ose fonde të tjera të ndryshme;

c) krijimet artistike të të gjitha llojeve dhe gjinive. Këtu nuk përfshihen krijimet e autorëve të gjallë;

ç) dokumente arkivore me rëndësi historike kombëtare;

d) dorëshkrime dhe botime, libra dhe periodikë me vlera të veçanta, historike dhe bibliografike;

dh) koleksionet e ndryshme filatelike, numizmatike të artit, me vjetërsi mbi 25-vjeçare;

e) pajisje tradicionale pune, mjeshtërie dhe jetese. Mekanizma, makineri ose objekte të përdorimit të përditshëm ose atij ceremonial, me vlera artizanale, etnografike ose historike, objektet e prodhuara në mënyrë artizanale, me vjetërsi mbi 50-vjeçare dhe objektet e fabrikuara me vjetërsi mbi 75-vjeçare;

ë) teknologji të prodhimit të produkteve të traditës;

f) armët e ftohta dhe të zjarrit, të prodhimit artizanal ose të fabrikuara përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore;

g) objekte personale të figurave të shquara historike;

gj) objektet e përfshira në inventarët e pasurive, të shpallura në ruajtje ose në mbrojtje, të rrjetit muzeal e të galerive të artit dhe të institucioneve shtetërore të vendit deri në vitin 1991.

II. Vlerat jomateriale të trashëgimisë kulturore janë:

1. Përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare.

2. Folklori gojor i ruajtur në kujtesë, i shkruar ose i regjistruar.

3. Folklori vokal, koreografik dhe instrumental.

4. Zakone dhe doke tradicionale.

5. Besime dhe bestyttni të traditës.
6. Zejet e ndryshme tradicionale.

Neni 5

(Shtuar pika 3 dhe 4 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Vlerat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore, që zbulohen ose krijohen, pavarësisht nga pronësia, mbrohen nga shteti.
2. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpall Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ngrihet Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje ka specialistë të fushës. Komiteti mbikëqyr veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe harton e miraton strategjitë e programet e zhvillimit në këtë fushë. Anëtarët e komitetit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje. Përbërja e këtij komiteti dhe masa e shpërblimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullorja dhe mënyra e funksionimit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozimin e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, shpall krijimet më të spikatura të trashëgimisë jomateriale “Kryevepër e trashëgimisë kulturore shpirtërore.

Neni 7

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Institucionet shtetërore, të specializuara sipas kriterëve shkencore, bëjnë përcaktimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore, të shpallura si të tilla, pronë e çdo personi fizik apo juridik, si dhe dokumentimin e tyre.

2. Këto objekte, në mënyrë të detyrueshme, duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, e cila lëshon pasaportën e objektit në bazë të këtyre të dhënave.

3. Çdo ndryshim i pronësisë së objektit duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 8

Çdo person fizik ose juridik është i detyruar të ruajë, sipas kriterëve të caktuara në këtë ligj dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, tërësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike që zotëron ose merr në përdorim.

Neni 9

(Shtuar fjalë në fund të pikës 1 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; hequr fjalë në pikën

4 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Objektet e trashëgimisë kulturore me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, që nuk janë në pronësi shtetërore, mund të koleksionohen, shiten, blihen, lihen trashëgim ose dhurohen ndërmjet shtetasve shqiptarë që jetojnë brenda vendit por, në çdo rast, të shoqëruar me pasaportën përkatëse të objektit..

2. Shteti shqiptar gëzon të drejtën e parablerjes së objekteve me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale të trashëgimisë kulturore, që ndodhen në pronësi private.

3. Çdo pronar që dëshiron të shesë një objekt të trashëgimisë kulturore, është i detyruar të paraqesë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve pasaportën e objektit. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pas këshillimit me organet e specializuara sipas fushave përkatëse, i kthen përgjigje pronarit të objektit brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Nëse Ministria është e interesuar për blerjen e këtij objekti, fillon procedurën e vlerësimit. Në rast të kundërt, pronari ka të drejtë të bëjë shitjen, duke i bashkëlidhur dokumentacionit të objektit mendimin me shkrim të institucionit që ka bërë vlerësimin e tij.

4. Për vlerësimin e objekteve në pronësi private të trashëgimisë kulturore të luajtshme, që nxirren jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ngrihet një komision i përhershëm me ekspertë nga institucionet shtetërore të specializuara, i cili, në përfundim të vlerësimit të objekteve, i rekomandon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lëshimin ose jo të autorizimit për nxjerrjen e këtyre objekteve jashtë territorit të vendit.

5. Funksionimi i komisionit, procedurat e vlerësimit dhe kriteret shkencore, përzgjedhja e anëtarëve dhe shpërblimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

(Zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore, për ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose e mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, bëhet nga institucionet shtetërore të specializuara.

2. Zhvendosja realizohet pasi këto institucione të kenë përgatitur dokumentacionin dhe studimet përkatëse dhe të kenë bërë regjistrimin e zhvendosjes në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 11

Shumëfishimi dhe riprodhimi i certifikuar i objekteve të trashëgimisë kulturore bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit, pasi është marrë leja e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 12

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Objektet e trashëgimisë kulturore në pronësi private, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale kur pronari refuzon të sigurojë kushtet për ruajtjen e tyre, kur e kërkon interesi publik, mund të shpronësohen në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi për shpronësimet.

Neni 13

(Ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Personat fizikë dhe juridikë, që kanë në pronësi objekte me vlera të trashëgimisë kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, të regjistruara, janë të detyruar të krijojnë kushtet e nevojshme për mirëmbajtjen e këtyre objekteve.

Për restaurimin e këtyre objekteve ata janë të detyruar t'u drejtohen institucioneve shtetërore të specializuara.

Mund të restaurojnë objekte të trashëgimisë kulturore, me miratimin e këtyre institucioneve, edhe subjektet e licencuara për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 14

Në rastin e fatkeqësive natyrore, të shembjes ose të djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, kur nuk vendoset kryerja e rikonstruksionit, mbi truallin e mbetur ose mbi pasurinë rrënojë, lejohet ndërtimi vetëm në sipërfaqen dhe vëllimin e mëparshëm, duke respektuar kategorinë dhe llojin e monumentit të dëmtuar.

Neni 15

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Institucionet shtetërore të specializuara, me leje të pronarit dhe në prani të tij, kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen fizike të objektit ose të objekteve në pronësi private.

2. Pronarët e çdo objekti, pas kërkesës së bërë nga institucionet e mësipërme, janë të detyruar të lejojnë kontrollin e gjendjes fizike të objektit.

Neni 16

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Institucionet shtetërore të specializuara shtetërore, në marrëveshje me pronarët dhe zotëruesit e objekteve të trashëgimisë kulturore, krijojnë kushte për ekspozimin e këtyre objekteve për publikun.

2. Fotografimi, filmimi ose regjistrimi kompjuterik dhe publikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, të ekspozuara në muzetë vendorë, bëhet pasi të jetë marrë leje nga institucioni shtetëror, në varësi të të cilit është muzeu. Për objekte të tilla, të ekspozuara në muzetë kombëtarë, autorizimi miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 17

(Ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; shtuar paragraf në pikën 1 me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjektet e licencuara për këtë qëllim, sipas pikave 3, 4 e 5 të këtij neni, si dhe nga institucionet e huaja të parashikuara në nenin 42 pika 3 të këtij ligji.

Veprimtaria restauruese e këtyre subjekteve private, e përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë VI.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.

2. Me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve krijohet Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, më poshtë KKR, i cili ka në përbërje përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara dhe personalitete të fushës. Organizimi dhe funksionimi i këtij Këshilli përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri.

3. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve miraton kriteret për licencimin e subjekteve e të personave fizikë a juridikë. KKR-ja, pas plotësimit të kriterëve të miratuara për këtë qëllim, i propozon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve licencimin e personave fizikë ose juridikë në fushën e projektimit apo të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.

4. Licenca për projektim dhe restaurim në fushën e trashëgimisë kulturore miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Punimet e restaurimit, të cilat kryhen nga subjektet e licencuara për këtë qëllim, mbikëqyren dhe kolaudohen nga institucionet shtetërore, të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

6. Çdo projekt për restaurim i paraqitet për miratim Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, i cili përcakton kriteret dhe kategorinë e projekteve, që miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

7. Zbatimi i punimeve të restaurimit të monumenteve të kulturës, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre nuk i nënshtrohen ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Rregullat dhe kriteret e punimeve të restaurimit në objektet e trashëgimisë kulturore përcaktohen në Kartën Shqiptare të Restaurimeve, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 18

(Ndryshuar fjalia e fundit, shtuar paragraf me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; shtuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Fondet për mirëmbajtjen, restaurimin, zbulimin dhe studimin e vlerave të trashëgimisë kulturore sigurohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nga të ardhurat e përdorimit të tyre, si dhe nga çdo e ardhur tjetër e ligjshme, që sigurohet nga fondacione, organizata dhe institucione, vendase ose të huaja, shtetërore ose private apo nga personat fizikë ose juridikë.

Të ardhurat dytësore, të siguruara nga përdorimi i monumenteve të kulturës në pronësi shtetërore, ndahen si më poshtë:

a) 90 për qind institucionit, që ka në administrim monumentin, për restaurimin, mirëmbajtjen dhe rijetëzimin e tij;

b) 10 për qind Buxhetit të Shtetit.

Përzgjedhja e subjekteve, të pajisura me leje, për restaurimin e monumenteve të kulturës, me fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Procedurat e konkurrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

TRASHËGIMIA KULTURORE E LUAJTSHME

Neni 19

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Lëvizja nga vendet e caktuara të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, në pronësi shtetërore, me vlera të zakonshme ose të veçanta, kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin, ekspozimin brenda vendit ose tjetërsimin e pronësisë, bëhet me autorizimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Lëvizja nga vendet e caktuara të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të zakonshme, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet me lejen e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Lëvizja e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e këtyre lëvizjeve përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim.

4. Në çdo rast, autorizimi i lëshuar regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 20

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006)

1. Objektet e trashëgimisë kulturore të veçantë, kombëtare dhe unike, nuk dhurohen e nuk shkëmbehen në asnjë rast.

2. Në raste të veçanta, objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme mund të dhurohen ose shkëmbehen ndërmjet institucioneve simotra në shtete të tjera, kur u shërbejnë interesave kombëtarë dhe janë të barazvlefshme. Dhurimi ose shkëmbimi bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet publike, që në fondin e tyre kanë në administrim objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të zakonshme, lejohen t'ua shesin të tretëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet procedurës së ankandit. Kushtet, rregullat dhe procedurat e organizimit të ankandit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

1. Shteti shqiptar bëhet menjëherë pronar i ligjshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore, të cilat nuk janë në pronësi shtetërore, por që janë të vjedhura ose të humbura, nëse pronari i tyre nuk identifikohet.

2. Shteti shqiptar bëhet menjëherë pronar i ligjshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, të cilat nuk janë në pronësi shtetërore, të nxjerra në mënyrë të jashtëligjshme jashtë vendit.

Neni 22

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006)

Objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme, arkivat dhe koleksionet e institucioneve shtetërore e joshtetërore, si dhe ato të ekspozuara në muzetë kombëtarë ose vendorë, shtetërorë ose joshtetërorë, mbrohen dhe administrohen sipas rregulloreve të vetë institucioneve, të cilat hartohen në përputhje me këtë ligj, si dhe me ligjet nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë” dhe nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

Neni 23

Në rastet kur godinat, ku ruhen arkiva shtetërore ose vlera të tjera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, u kthehen ish-pronarëve dhe shpronësimi është i pamundur, Këshilli i Ministrave bën sistemimin në mjedise të tjera të përshtatshme të këtyre institucioneve.

KREU III TRASHËGIMIA KULTURORE E PALUAJTSHME

Neni 24

(Zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Objekti i trashëgimisë kulturore ka këto shkallë mbrojtjeje:
 - a) nën vrotim;
 - b) në mbrojtje paraprake;
 - c) monument kulture të kategorisë II ;
 - ç) monument kulture të kategorisë I.
2. Objektet në grup emërtohen sipas rastit: park arkeologjik, qytet-muze, zonë-muze, qendër historike, zonë arkeologjike dhe ansambël-muze.
3. Heqja e plotë ose e pjesshme e mbrojtjes nga shteti e një objekti ose grupi objektësh të trashëgimisë kulturore është e drejtë ekskluzive e organit që e ka shpallur atë.

Neni 25

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006)

1. Objekte në vrotim janë të gjitha objektet në gjendje rrënoje, kështjellat, objektet e kultit, ndërtimet inxhinierike, ndërtimet publike ose të luksit, të ndërtuara përpara vitit 1900, si dhe ato në shfrytëzim, të ndërtuara përpara vitit 1944 dhe, në raste ndërtimesh të spikatura, edhe pas këtij viti. Statusi “Objekte në vrotim” shpallet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për një afat kohor prej 6 muajsh.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i propozon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpalljen ose jo të këtyre objekteve “Monument kulture” të kategorisë I apo II.

2. Ndryshimi ose heqja e këtij statusi bëhet me kërkesë të pronarit të objektit drejtuar Institutit të Monumenteve të Kulturës.

3. Objekti me këtë status nuk mund të priset ose t'i bëhen ndryshime, pa miratimin me shkrim të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Neni 26

1. Objekt në mbrojtje paraprake shpallet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës çdo objekt me vlera të veçanta. Ky status është 6-mujor dhe brenda kësaj periudhe ky institucion duhet të kryejë procedurat për përcaktimin e statusit të mëtejshëm të tij.

2. Gjatë kësaj periudhe ndalohet çdo lloj ndërhyrje në gjendjen fizike të objektit.

Neni 27

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Monumente kulture të kategorisë II janë ndërtimet me vlera të spikatura, kryesisht në pamjen e tyre të jashtme. Ato ruhen në vëllime dhe pamjen e tyre të jashtme. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore i shpall ato monumente kulture të kategorisë II.

Neni 28

1. Monumente Kulture të kategorisë I janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre

arkitektonikë dhe teknikë.

2. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

3. Ndërtimet e reja pranë tyre duhet të respektojnë distancat e zonës së mbrojtur.

4. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i shpall ato monumente kulture të kategorisë I.

Neni 29

(Ndryshuar fjalia e fundit e pikës 3 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objektesh është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike shpallen të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Rregullorja e administrimit për kategorinë e objekteve të mësipërme dhe zonën e mbrojtur rreth tyre miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Heqja e plotë ose pjesshme e shkallës së mbrojtjes në këtë kategori objektesh bëhet me vendim të po atij organi, që e ka vendosur atë.

6. Monumentet e kulturës të kategorisë I dhe II në qendrat historike, qytetet-muze dhe ansamblet-muze mund të shfrytëzohen edhe për funksione të tjera, që nuk cenojnë në asnjë mënyrë vlerat e tyre. Aty mund të vendosen institucione shetërore ose private, si muze, biblioteka, atelie monumentesh, fototeka, galeri artesh dhe ekspozita të ndryshme.

Neni 30

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Zonat dhe parqet arkeologjike shpallen të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të bërë nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona “A” dhe zona “B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Rregullorja e administrimit të këtyre zonave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të bërë nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Në zonat arkeologjike “A” është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.

4. Në zonat arkeologjike “B” lejohen ndërtimet e reja në rastet e përcaktuara në rregulloren e administrimit të këtyre zonave, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

Neni 31

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Institucionet shtetërore, të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, organet e qeverisjes vendore dhe pronarët ose përdoruesit e objektit kanë të drejtën e propozimit për shpalljen e një objekti “Monument kulture”, propozim i cili i drejtohet ministrit përgjegjës për

trashëgiminë kulturore.

Neni 32

(Shtuar fjali në fund të pikës 2 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Për monumentet e kulturës përcaktohet një sipërfaqe toke ose trualli përreth, si zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike, me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike, me rrethinën dhe me rrethanat ekologjike.

2. Përmasat e zonës mbrojtëse përcaktohen nga organi që shpall monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në këtë zonë ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor.

Neni 33

(Zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në monumentet e kulturës, si dhe çdo ndryshim në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre, bëhet vetëm me autorizimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, Institutit Arkeologjik, për gërmimet shkencore, si dhe të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, në rastet e gërmimeve të shpëtimit.

2. Ndalohet gërmimi me karakter arkeologjik dhe përdorimi i aparaturave metalkërkuese nga njerëz ose subjekte të paautorizuara.

Neni 34

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; zëvendësuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me institucionet shtetërore të specializuara për ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, që ndodhen në territoret në juridiksionin e tyre. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përcakton mënyrat e bashkëpunimit.

Neni 35

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit dhe të rigjallërimit të monumenteve të kulturës kryhen me fonde të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të donatorëve të tjerë ose të vetë pronarëve, pasi të jetë miratuar projekti i tyre nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 36

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 2 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Në monumentet e kulturës të kategorive I dhe II, pronë e subjekteve joshtetërore, shteti përballon të gjitha shpenzimet për ruajtjen e vlerave historiko-artistike, të cilat nuk lidhen me qëndrueshmërinë e objektit.

2. Punimet e tjera të restaurimit për këto monumente përballohen në masën:

a) 60 për qind nga shteti dhe 40 për qind nga pronari, për monumentet e kulturës të kategorisë I;

b) 30 për qind nga shteti dhe 70 për qind nga pronari për monumentet e kulturës të kategorisë II.

Neni 37

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; shtuar fjalë në fund të pikës 1 me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Kur pronari joshtetëror i monumentit të kulturës nuk ka fonde për kryerjen e punimeve të restaurimit, pas planifikimit të këtyre punimeve, shteti ndërmjetëson pranë bankave për përfitimin e kredive afatgjata me kushte lehtësuese si dhe merr përsipër shlyerjen e interesit të kredisë.

2. Kur pronari kundërshton kredinë dhe kur monumenti është në rrezik shembje, punimet e restaurimit bëhen edhe pa pëlqimin e tij nga drejtoria rajonale e kulturës kombëtare nëpërmjet drejtorive rajonale të monumenteve të kulturës ose edhe nga subjekte të tjera të licencuara për këtë qëllim. Pas përfundimit të punimeve, pronari detyrohet të paguajë pjesën e vet të shpenzimeve, në përputhje me nenin 36 të këtij ligji.

Neni 38

Çdo vendim i marrë nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.

Neni 39

(Ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008; shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Monumentet e kulturës mund të rijetëzohen për qëllime administrative dhe social-kulturore, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerën e monumentit. Kushtet dhe kriteret paraprake të rijetëzimit dhe të shfrytëzimit të monumenteve të kulturës miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

1/1. Rijetëzimi ose shfrytëzimi i Monumenteve të Kulturës, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VI.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje jepen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

2. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet palëve.

3. Kontrata e shfrytëzimit lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe përdoruesit të monumenteve. Në rast se përdoruesi shkel kushtet dhe kriteret e kontratës, atëherë drejtoria rajonale e kulturës kombëtare i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 40

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Vendosja e materialeve publicitare në objektet monument kulture bëhet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm.

2. Veprimtaritë kulturore në objektet monument kulture bëhen vetëm në rastet kur ato nuk rrezikojnë ose cenojnë vlerat e tyre.

3. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve jep autorizimin për organizimin e

veprimtarive kulturore dhe vendosjen e materialeve publicitare.

Neni 41

Kërkimet, sondazhet dhe gërmimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë monopol i shtetit shqiptar.

Neni 42

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, e krijuar për të ushtruar veprimtari në fushën e gërmimeve dhe të studimeve të trashëgimisë kulturore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit. Organizimi dhe funksionimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Statuti i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohet me urdhër të ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Struktura dhe organika e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë është organ kolegjal vendimmarrës, që përbëhet nga specialistë të fushave përkatëse, i cili mbledhet periodikisht pranë ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe kryesohet nga ministri. Përbërja, mënyra e funksionimit, kompetencat dhe shpërblymimi i anëtarëve të këshillit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008; shtuar paragraf me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e përshkruara në nenin 41 realizohen nga institucione shtetërore dhe private të specializuara të fushës përkatëse, vendase ose të huaja. Këto bashkëpunime bëhen në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe. Përjashtohet ekskluziviteti i institucioneve të huaja në këto veprimtari. Për bashkëpunim, në çdo rast, merret miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Veprimtaria kërkimore arkeologjike e këtyre subjekteve private përfshihet në kategorinë VI.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.

Neni 44

Objektet arkeologjike, të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike, janë pronë e shtetit shqiptar.

Neni 45

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Personat fizikë ose juridikë, që zbulojnë ose gjejnë, në mënyrë të rastësishme, objekte të trashëgimisë kulturore, janë të detyruar që brenda 20 ditëve të njoftojnë organet vendore të kulturës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe drejtoria rajonale e kulturës kombëtare, duke deklaruar mënyrën dhe vendin e gjetjes. Pas dokumentimit të objektit, komisioni i ngritur për

këtë qëllim me specialistë të këtyre institucioneve përcakton vlerat dhe vendos për statusin e mëtejshëm të objektit, si dhe shpërblimin e këtij personi.

Neni 46

(Ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, nëpërmjet strukturave të veta dhe në bashkëpunim edhe me persona juridikë dhe fizikë, të licencuar në këtë fushë, bën ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike, që dalin gjatë punimeve bujqësore, të ndërtimit, veprave inxhinierike ose konstruksioneve ndërtimore dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave.

Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të punimeve që dëmtojnë vlerat arkeologjike. Veprimet e mëtejshme vendosen nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë jo më vonë se 10 ditë nga ndërprerja e punimeve.

Neni 47

(Zëvendësuar fjalë dhe ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

Në rastet e ndërtimeve të mëdha në territore në pronësi shtetërore ose private, si rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, investitorët janë të detyruar që, gjatë procesit të projektimit dhe zbatimit të projektit, të marrin miratimin, me shkrim, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë. Specialistët kryejnë kontrollin e zonës dhe përgatisin dokumentacionin përkatës. Kur zona përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, etnografike ose gjurmë të arkitekturës së lashtë ose tradicionale, projekti duhet të ndryshojë. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe ndryshimet e mundshme të projektit kryhen nga investitori.

Neni 48

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Kur, pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë.

Drejtuesit dhe investitorët e punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve, organet e qeverisjes vendore, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe drejtorinë rajonale të kulturës kombëtare, të cilët bëjnë kontrollin përkatës, raportojnë për vlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo të punimeve.

2. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime ose të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve.

3. Në rastin kur punimet pësojnë ndryshime, të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese, mbulohen 100 për qind nga investitori.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 49

1. Janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, kur nuk përbëjnë vepër

penale, shkeljet e mëposhtme:

- a) shkeljet sipas nenit 7 dënohen me gjobë nga 10 000 -20 000 lekë;
- b) shkeljet sipas nenit 8 dënohen me gjobë nga 30 000 - 50 000 lekë;
- c) shkeljet sipas neneve 11 dhe 19 dënohen me gjobë nga 20 000 - 50 000 lekë;
- ç) shkeljet sipas nenit 14 dënohen me gjobë nga 100 000 - 500 000 lekë;
- d) shkeljet sipas nenit 16 pika 2 dënohen me gjobë 20 000 lekë;
- dh) shkeljet sipas neneve 25 pika 3 dhe 26 pika 2 dënohen me gjobë nga 100 000 - 300 000 lekë;
- e) shkeljet sipas nenit 28 pika 2 dënohen me gjobë nga 100 000 - 500 000 lekë;
- ë) shkeljet sipas nenit 33 pika 1 dënohen me gjobë nga 50 000 -500 000 lekë;
- f) shkeljet sipas nenit 45 dënohen me gjobë nga 10 000 - 50 000 lekë;
- g) shkeljet sipas nenit 33 pika 2 dënohen me gjobë 100 000 lekë dhe konfiskim të aparaturës;
- gj) shkeljet sipas neneve 47 dhe 48 pika 1 dënohen me gjobë nga 1 000 000 - 5 000 000 lekë.

2. Dëmi i shkaktuar në objektet unike të trashëgimisë kulturore përbën në çdo rast vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit penal.

Neni 50

(Ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008)

1. Të drejtën e vënies së gjobës e kanë inspektorët e institucioneve shtetërore të specializuara, sipas fushave që mbulojnë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Kundërvajtësi duhet ta paguajë gjobën brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit për lënien në fuqi të gjobës. Gjobat paguhën pranë zyrave të financës në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Në rast mospagimi të gjobës brenda afatit të mësipërm, vendimi për lënien në fuqi të gjobës përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet zyra e përmbarimit.

4. Shuma e arkëtuar nga vjelja e gjobave derdhet 40 për qind në favor të Buxhetit të Shtetit dhe 60 për qind në favor të institucionit, që ka në juridiksion objektin.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 51

Çdo person fizik ose juridik, që zotëron objekte, të cilat janë vlera të trashëgimisë kulturore të luajtshme, duhet t'i deklarojë ato pranë organeve të kulturës, të qeverisjes vendore dhe ta regjistrojë objektin në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, sipas mënyrës që ofron kjo qendër, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 52

Për objektet monument kulture të dhëna me qira përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kontrata e qiramarrjes, për periudhën e mbetur, rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 53

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Instituti i Arkeologjisë, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i paraqesin për miratim Këshillit të Ministrave zonat arkeologjike brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë.

2. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Instituti i Arkeologjisë i paraqesin për miratim Këshillit të Ministrave kufijtë dhe rregulloret e administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet shtetërore të specializuara në varësi të Ministrisë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, statutet e të cilave miratohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bëjnë rishikimin e këtyre statuteve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 54

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 9 pika 5, 19 pika 3, 20 pika 2, 23, 29 pika 2 dhe 31 pika 1, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 55

Ligji nr.7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme", shfuqizohet.

Dispozita kalimtare dhe të fundit (E ligjit nr. 9882, datë 28.2.2008)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 13,14 dhe 23 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 e 23 të këtij ligji.

Neni 56

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3804, datë 5.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**